

Implementimi i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm në Kontekstin Shqiptar.

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Perspektivë LGBTI+

Autore dhe Redaktuese:
Kontributorë:
Dizenjoi:

M.A Dea Nini
Xheni Karaj, Anisa Metalla, Arsita Mati
Joan Kamberaj

SUSTAINABLE
DEVELOPMENT
GOALS



© Aleanca kundër diskriminimit LGBT
www.aleancalgbt.org

PËRMBAJTJA

Lista e Shkurtesave	4
Hyrje	5
Parathënie	6
I. OZHQ 3	8
II. OZHQ 4	13
III. OZHQ 5	18
IV. OZHQ 8	20
V. OZHQ 10	23
VI. Rekomandime	33

LISTA E SHKURTESAVE

LGBTI+	Lesbique, Gej, Biseksualë, Transgjinnorë, Interseks +
LBTI	Lesbique, Biseksuale, Transgjinnore, Interseks
OZHQ	Objektiva të Zhvillimit të Qendrueshëm
HLPF	Forumi i Nivelit të Lartë Politik
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UPR	Rishikimi i Përgjithshëm Periodik
IVF	Fertilizim In Vitro
CEDAW	Komiteti mbi Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
BE	Bashkimi European
ECRI	Komisioni European kundër Racizmit dhe Intolerancës
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
Aleanca LGBT/Aleanca	Aleanca kundër diskriminimit LGBT
OHCHR	Zyra e Komisionerit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut
LMD	Legjislacioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
OSISHGJKS	Orientim Seksual, Identitet dhe Shprehje Gjinnore, Karakteristika të Seksit

Ky raportim, i cili realizohet në kuadër të Forumit të Lartë Politik 2020, synon të hedhë dritë mbi nivelin e implementimit të disa Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, nisur nga konteksti kombëtar dhe situata aktuale e komunitetit LGBTI+, në kuadër të angazhimit të shtetit shqiptar ndaj Agjendës 2030.

Në krye të herës, vlerësojmë angazhimin e Qeverisë Shqiptare në platformën e zhvillimit të qëndrueshëm, mes Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim dhe Programit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe hapat e ndërmarra në benefit të kauzës LGBTI+, sidomos në planin ndërkombëtar, duke përmendur veçanërisht antarësinë në Grupin Qendror LGBTI+ në New York, mes 29 shteteve anëtare nga e gjithë bota.

Ky qëndrim, lidhur me të cilin në kontekstin kombëtar dihet shumë pak dhe që është thuajse i panjohur nga vetë personat dhe organizatat LGBTI+ në Shqipëri, është vendimtar. Siç theksohet në deklaratën e përbashkët të 29 shteteve, në kuadër të rinovimit të mandatit të Ekspertit të Pavarur të Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Orientimit Seksual dhe të Identitetit Gjinator, ku ndër palët që votuan pro rinovimit dhe nënshkruan këtë deklaratë është edhe Shqipëria, një shoqëri gjithëpërfshirëse i mundëson kujtdo, përfshirë individëve LGBTI+ mbrojtje nga dhuna dhe diskriminimi dhe akses të plotë në gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut¹. Inkurajojmë Qeverinë Shqiptare, që në vijim të bëjë më transparente qëndrimet dhe angazhimin e saj në këto nivele, mes deklaratave publike, të cilat janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për çdo person LGBTI+ që jeton në Shqipëri.

Objekt i raportimit tonë është niveli i implemenimit të objektivave 3, 4, 5, 8 dhe 10, nisur nga vetë spektri i tyre i veprimit, që prek çështje mjaft të rëndësishme dhe delikate, si shëndetësia, edukimi, punësimi, situata specifike e grave dhe vajzave LGBTI+ si dhe marrja e masave konkrete me natyrë juridike në benefit të problematikave me të cilat përballen sot individët LGBTI+.

Axhenda 2030, ka hyrë në dekadën e saj të fundit të veprimit dhe siç shihet edhe nga tematika e zgjedhur nga Forumi i Lartë Politik për këtë vit, nga Shtetet Anëtare në këtë 10-vjeçar pritet marrja e masave të përshpejtuara dhe ndjekja e planeve transformuese drejt përmbushjes së plotë të objektivave ndaj të cilave janë zotuar. Siç shprehet edhe Eksperti i Pavarur i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, detyrimi i shteteve në adresimin e dhunës dhe diskriminimit mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinator, mbetet thellësisht i ndërthur me parimin kryesor të Agjendës 2030 për të mos lënë askënd mënjanë².

Për hartimin e këtij raporti aplikua metodat cilësore dhe sasiore të kërkimit shkencor, duke kombinuar rishikimin e korpusit të raporteve vjetore të organizatave partnere për periudhën 2015-2020, databazave të të dhënave të disponuara nga Aleanca LGBT, akteve të ndryshme me karakter juridik si dhe literaturës ndërkombëtare lidhur me platformën e zhvillimit të qëndrueshëm dhe çështjet LGBTI+.

¹Deklaratë e Grupit Qendror LGBTI+ lexuar nga Znj. Egriselda Aracely Gonzalez Lopez- Ambasadore e Përfaqësisë së El Salvador në Kombet e Bashkuara; 18 Tetor 2019; New York.

²<https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23092&LangID=E>

Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave ishte planifikuar të mbledhej mes fokus grupeve me anëtarët e komunitetit, por duke qenë se situata e izolimit social për shkak të COVID-19, na pamundësoi grumbullimet fizike, zgjodhëm të përdornim pyetësorët online si një nga burimet kryesore të të dhënave.

Pyetësori i publikuar në fund të muajit Mars u plotësua nga 101 anëtarë të komunitetit, një shifër kjo më e lartë se pritshmëritë tona fillestare, duke njohur hezitimin e personave LGBTI+ drejt dhënies së informacioneve dhe të dhënave personale e sensitive, sidomos mes mjeteve të teknologjisë.

Të dhëna të tjera sasiore janë analizuar nga pyetësorët e realizuar ndër vite nga Aleanca LGBT si edhe nga fokus grupe e takime të mëparshme me anëtarë të komunitetit, duke qenë se i shërbenin më së miri objektit të këtij raportimi, çka e bën korpusin e informacionit më të plotë, me të dhëna të shtrira progresivisht në kohë.

Një pjesë e gjetjeve i atribuohet numrit të konsiderueshëm të takimeve me përfaqësues nga organizata të të drejtave të njeriut në Shqipëri, të cilat nuk ngurrojnë të japin inpute me vlerë nga eksperiencia e tyre, sa herë flitet për kauzën LGBTI+.

Gjejmë rastin të falenderojmë të gjithë anëtarët e komunitetit, kolegët nga organizatat partnere dhe përfaqësuesit e institucioneve për kontributin e tyre në këtë raportim.



**The SDGs apply to you as well!
They leave no one behind!**

PARATHËNIE

Në kohën që po jetojmë, të dhënat që raportohen për situatën e të drejtave të njeriut në përgjithësi duket të jenë jo brenda kontureve të pritshmërive në drejtim të avancimit dhe realizimit progresiv. Pandemia që Bota po përjeton rishtazi, qartësisht ka ndikuar dhe me gjasë do të ndikojë të drejtat themelore në rend regresiv në të ardhmen veçanërisht në vende me demokraci të brishta si Shqipëria dhe sfidat e shumëfishta që këto vende do të duhet të përballojnë.

Është shqetësues konstatimi se shumë vende në Europë po bëjnë hapa prapa në aplikimin e masave mbrojtëse ndaj komunitetit LGBTI+³ veçanërisht dhe në mënyrë të pavaruar nga kriza pandemike, gjë e cila e thellon edhe më tepër mprehtësinë e problem-it. Të gjendur para një situatë të tillë, vigjilenca për të monitoruar, mbajtur të dhëna dhe raportuar mbi objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, si një agjendë Botërore ndaj të cilës shtetet janë zotuar, merr një rendësi tepër të veçantë. Shqipëria është mes këtyre vendeve, e cila përmes Programit të Bashkëpunimit me Kombet e Bashkuara për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2017-2021⁴ ka detyrimet e saj për të progresuar realizimin e të drejtave,

³Shiko ILGA Europe, Rainbow map and index 2020, i disponueshëm online në: <https://www.ilga-europe.org/rainboweurope/2020>

⁴Programi i disponueshëm online në: <https://www.un.org.al/sites/default/files/POC2021EnSig.pdf>

veçanërisht në drejtim të komuniteteve më vulnerabël siç është komuniteti LGBTI+. Kjo paraqet sfida veçanërisht në kontekstin vendas, i cili ende përballet me një sistem drejtësie prej disa vitesh në një përjekje për t'u reformuar, por që mbetet ende me papërgjegjshmëri, bashkëpunim të dobët ndërinstitucional, prapambetje dhe korrupsion, dhe si i tillë i papajisur për të siguruar nevojat e segmenteve të marginalizuara dhe të përjashtuara të shoqërisë⁵.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)⁶, në raportimet e tij të vazhdueshme për Shqipërinë ka lëshuar rekomandime specifike në kuadër të avancimit të mbrojtjes së komunitetit LGBTI+, duke filluar nga forcimi i kuadrit ligjor në fushën civile e administrative duke paraqitur iniciativa ligjvënëse gjithëpërfshirëse për të luftuar diskriminimin e drejtëpërdrejtë e atë indirekt në të gjithë fushat e jetës, si dhe deri tek rekomandimet konkrete për autoritetet shqiptare si përsëmbull ai për të garantuar njohjen e plotë ligjore të ndryshimit të gjinisë së personit, në veçanti duke bërë të mundur ndryshimin e emrit dhe gjinisë në dokumentet zyrtare në mënyrë të shpejtë, transparente dhe të aksesueshme.

Është themelore në procesin e avancimit progresiv, të respektimit, mbrojtjes e përmbushjes së të drejtave themelore, kryerja e kërkimeve sistematike si dhe mbledhja e të dhënave lidhur me intolerancën dhe diskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, përfshirë sondazhet për qëndrimin dhe qasjet e vetë komunitetit LGBTI+.

Është e qartë që Shqipëria në kuadër të anëtarësimit në Bshkimin Evropian është e angazhuar politikisht dhe strategjikisht në një agjendë sfiduese për integritet.⁷ Megjithatë është thelbësore matja dhe perceptimi i komunitetit vetë dhe grupeve të interesit sa u takon aspekteve të zhvillimit, për të hedhur dritë nëse angazhimet janë vërtetë të qenësishme dhe efektive dhe jo konturime dhe ornamente të dialogëve politikë. Miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI+ për vitin 2016-2020⁸ solli një energji dhe shpresë se politikat sociale dhe ekonomike do të ndikojnë ndjeshëm në përmirësimin e jetës dhe respektimin e dinjitetit të komunitetit. Tashmë që ky dokument politikash është në vitin e fundit të implementimit të tij, ka vend për të analizuar frytet dhe të nxirren mësimet, dhe kjo jo vetëm duke ju referuar këtij programi specifikisht, por në tërësi zhvillimit dhe perceptimit që vetë komuniteti ka për të. Duket që panorama nuk është shumë larg trendit Evropian që sipërpërmendëm, por le të shpresojmë që regresi të jetë sa më i vogël.

⁵Ibid, faqe 21.

⁶Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës, raportimet për Shqipërinë të disponueshme online në: <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-and-intolerance/albania>

⁷Dokumentii-i strategjisë i disponueshëm online në: <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>

⁸Plani i disponueshëm online në: <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

3 SHËNDET I MIRË DHE MIRËQENIE



Objekti 3 ka në fokus sigurimin e jetesës së shëndetshme dhe mirëqënien fizike të çdokujt. Secili objektivi i zhvillimit të qëndrueshëm përbëhet nga disa targete, arritja e të cilave matet me indikatorëve respektivë. Në kuadër të situatës së implementimit të Objektivit 3 nga perspektiva LGBTI+, do të marrim në konsideratë targetin 3.7 dhe 3.8, të cilët lidhen posaçërisht me mundësimin e aksesit të plotë në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues dhe me mbulimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë anëtarët e shoqërisë, mes detyrimeve pozitive të shtetit.

Nga të dhënat e mbledhura ndër vite, rezulton se individët LGBTI+ për shkak të orientimit të tyre seksual, identitetit gjinor, shprehjes dhe karakteristikave të seksit, përveç statusit të tyre ekonomik, prejardhjes, gjinisë, etnisë apo çdo karakteristike tjetër që mund t'i bëjë objekte potenciale të diskriminimit të shumëfishtë⁹, ndeshen me vështirësi sa i përket aksesit të institucioneve shëndetësore dhe marrjes së shërbimeve mjekësore.

Nga të dhënat e dy viteve të fundit rezulton, se gjatë vitit 2018, vetëm stafi i Aleancës LGBT ka shoqëruar në institucionet e shërbimit shëndetësor 14 persona, nga ku 11 i përkisnin komunitetit transgjinnor dhe 3 komunitetit gej, të cilët nuk kishin asnjë mundësi të merrnin shërbimet shëndetësore që u nevojiteshin përveçse të shoqëruar.

Situata nuk duket të jetë përmirësuar gjatë vitit 2019, ku vetëm nga stafi i Aleancës LGBT janë shoqëruar për të marrë shërbimet e nevojshme mjekësore 33 persona LGBTI+.

Nga statistikatat e dy viteve të fundit të mbajtura nga Aleanca LGBT, duket se personat transgjinnorë janë më të diskriminuarit në radhët e anëtarëve të tjerë të komunitetit që nuk mund të aksesojnë shërbimet mjekësore. Vlen të theksojmë se aktualisht në Shqipëri nuk ofrohet mundësia e ndjekjes së terapive hormonale apo e ndërhyrjeve kirurgjikale të ndërrimit të seksit, duke u mohuar transgjinnorëve marrjen e këtyre shërbimeve, një fakt ky që theksohet edhe në raportin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut "Diskriminimi mbi Bazat e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor në Europë", ku Shqipëria renditet si një nga shtetet ku mungojnë parashikimet për trajtimet specifike që performohen mbi personat transgjinnorë dhe ku kostot e rehabilitimit pas ndërhyrjeve të tilla janë tejet problematike¹⁰. Edhe në studimin e Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut theksohet fakti, se skema kombëtare shëndetësore në Shqipëri nuk mbulon operacionet e ndërrimit të seksit dhe se spitalet shqiptare nuk janë teknikisht të përgatitura t'i kryejnë këto ndërhyrje¹¹. Duke qenë se kemi të bëjmë me trajtime inekzistente, nuk jemi ende në fazën e të diskutuarit mbi mbulimin e tyre nga skema e sigurimeve shëndetësore apo për kosto të tjera, të cilat janë në fokus të retorikave në vende të tjera të Ballkanit.

⁹<https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23092&LangID=E>, Pgph. 3.

¹⁰Komisioneri për të Drejtat e Njeriut; Diskriminimi mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor në Europë- Edicioni II: Seksioni 5.2.

¹¹Instituti Danez- COWI; Studim mbi Homofobinë, Transfobinë dhe Diskriminimin mbi Bazat e Orientimit Seksual dhe Identitetit Gjinor- Raport Juridik.

Fakti që në shtetin shqiptar nuk mundësohen trajtimet specifike, të nevojshme për personat transgjinorë dhe as nuk krijohet mundësia e marrjes së tyre jashtë vendit mes mbulimit të të gjitha apo një pjese të kostove nga fondi i sigurimit shëndetësor, mbi baza të trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues, tregon se shteti cedon të garantojë të drejtën themelore të personave transgjinorë për akses të plotë dhe efektiv në shërbimet shëndetësore, duke ndikuar njëherazi në mospërmbyshjen e garancive të synuara nga Objektivi 3 i zhvillimit të qëndrueshëm.

Në një moment ku pritet nga shtetet marrja e masave të përsheptuara dhe transformuese për implementimin e të gjitha objektivave, duke qenë se jemi në dekadën e fundit të veprimit të Agjendës 2030, por edhe duke marrë parasysh faktin se gjatë Rishikimit të fundit Periodik në Maj të 2019-ës Shqipëria nuk e mori parasysh rekomandimin lidhur me marrjen e masave për të mundësuar kalimin e një ligji për njohjen e identitetit gjinor për të paktën 4 vitet e ardhshme, çka lë personat transgjinorë në një gjendje pasigurie të nxitur nga mospërputhja mes situatës së tyre faktike dhe asaj të pasqyruar juridikisht, vlerësojmë se shteti shqiptar është në limitet e kohës për të marrë hapa konkrete në mënyrë që të sigurojë implementimin e Axhendës 2030, pa lënë mënjanë personat transgjinorë.

Nga ana tjetër, situata e personave interseks mbetet tejte e vagullt, pasi shifrat e sakta lidhur me numrin e foshnjave të lindura interseks mbeten të paqarta dhe po kështu informacioni lidhur me kirurgjitë e performuara mbi to, pasi kemi një përzierje të rasteve të cilësuar si ambiguitet seksual me ato të të lindurve me hiperplasi. Siç shpjegohet në studimin e ISNA-s, gjendja e hiperplasisë kongenitale adrenale është një ndër shkaqet që prevalon në shkaktimin e interseksualitetit te personat me kombinimin kromozomik XX, por jo tek ata me kombinim kromozomik XY¹². Në terma të thjeshta, shkencërisht pranohet se gjendja e hiperplasisë në shumë raste mund të jetë indikator edhe për interseksualitetin, por jo gjithmonë.

Gjendja e interseksualitetit ende patologjizohet nga mjekët, duke u parë si çrregullim i zhvillimit seksual dhe jo si një zhvillim i ndryshëm seksual¹³.

Përfaqësuesja nga organizata TLAS, e cila është marrë specifikisht me rastet e femijëve interseks qysh prej 2015-ës, tregon se në një tryezë të parë të mbajtur mbi çështjen në maj 2017, mjekët shpreheshin se personelit shëndetësor në përgjithësi i mungonte informacioni, trajnimi dhe kuptimi i përgjithshëm lidhur me çështjet interseks. Ndërkohë ata pranonin se kirurgjia infantile mbi fëmijët interseks ishte e përhapur në Shqipëri.

¹²<https://isna.org/faq/conditions/cah/>

¹³<https://www.unfe.org/wp-content/uploads/2017/05/UNFE-Intersex.pdf>

Në një seri ligjesh¹⁴ përcaktohet, se personat që i nënshtrohen ndërhyrjeve kirurgjikale në Republikën e Shqipërisë duhet të japin pëlqim të shprehur lidhur me to, por në rastin e foshnjave interseks ndërhyrjet kryhen në një moshë fare të vogël, ku individit nuk e ka kapacitetin juridik për të dhënë këtë pëlqim. Nga ana tjetër, ligji¹⁵ "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi" përcakton detyrimin pozitiv të shtetit për të mbrojtur personat LGBTI+ në mënyrë të barabartë me të gjithë shoqërinë, mbi parimin e barazisë në trajtim. Nga situata dhe faktet e sipërpërmendura kuptojmë se kjo bazë ligjore nuk respektohet në rastin e foshnjave interseks.

Ndërhyrjet e performuara mbi këto foshnja janë në të shumtën e rasteve të pakthyeshme dhe mund të shkaktojnë infertilitet, humbje të ndjeshmërisë seksuale, dhimbje dhe probleme psikologjike¹⁶.

Nga intervista me përfaqësuesen e TLAS, informohemi se përmes një kërkesë për informacion që organizata kishte drejtuar lidhur me numrin e ndërhyrjeve kirurgjikale të anomalive kongenitale të organeve gjenitale te fëmijët e mitur, rezulton se në vitin 2017 janë kryer 120 ndërhyrje, në vitin 2018 janë kryer 106 të tilla dhe përgjatë 2019-ës janë kryer 83 ndërhyrje. Në përgjigje cilësohet se vetëm në 2 raste gjatë vitit 2018 janë kryer kirurgji për ndryshimin e gjinisë. Këto shifra mbeten tejet të paqarta sa u përket foshnjave interseks mbi të cilat janë kryer ndërhyrje kirurgjikale, pasi gjendja e interseksualitetit jo në të gjitha rastet është e dukshme dhe lidhet me faktorët fizikë. Ajo mund të jetë e lidhur me ndërtimin kromozomik të individit dhe të mos shfaqë tipare të dukshme¹⁷.

Gjithashtu gjendja interseks është shpesh e lidhur me hiperplasinë, çka tregon se dy rastet e vetme të referuara në përgjigje si operacione të performuara për ndryshimin e gjinisë tregojnë vetëm dy raste të foshnjave interseks që kanë shfaqur tipare të dukshme të interseksualitetit. Ndërkohë nuk ka të dhëna mbi foshnjat hiperplasike që mund të jenë edhe interseks.

Dëshmi1: Nuk kemi pse presim derisa fëmija të rritet dhe të mund të shprehë pëlqimin e tij apo të saj për kirurgjinë, pasi ai/ajo duhet të rritet duke i përkuar një kategorie të përcaktuar gjinore përpara se të arrijë pjekurinë. Një person nuk mund të jetë njëkohësisht dhe vajzë dhe djalë edhe pse mund të ketë lindur me karakteristika të të dy seksve. Është në të mirë të këtyre foshnjave kirurgjia në moshë të hershme, pasi u jep mundësinë t'i përkasin një kategorie gjinore të caktuar në të ardhmen, duke i mbrojtur nga krizat e identitetit dhe nga konfuzioni¹⁸.

Dëshmi 2: I informova prindërit se fëmija e tyre ishte vajzë, e lindur me një klitor të zmadhuar, por ata vendosën që e donin djalë, pasi u kishin thënë të afërmeve që fëmija që lindi ishte djalë dhe tashmë i kishin vendosur edhe emrin. Në fund unë bëra atë që më kërkuan¹⁹.

¹⁴Ligji Nr.10107/2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"; Ligji Nr. 8876/2002 "Për shëndetin riprodhues".

¹⁵Ligji Nr.10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi"

¹⁶<https://www.unfe.org/wp-content/uploads/2017/05/UNFE-Intersex.pdf>

¹⁷<https://www.unfe.org/wp-content/uploads/2017/05/UNFE-Intersex.pdf>

¹⁸UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

¹⁹UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

Aktualisht, personat interseks nuk përmenden në ndonjë strategji apo dokument me natyrë juridike që lidhet me shërbimet mjekësore, duke u përjashtuar nga nevoja për trajtime dhe procedura specifike të menaxhimit të rasteve për shkak të interseksualitetit të tyre.

Mungesa e deritanishme e protokolleve mjekësore të shkruara sjell që diagnoza të përcaktohet gojarisht midis mjekëve dhe prindërve. Edhe në ato raste kur interseksualiteti regjistrohet nga mjekët dhe prindërit vendosin që të mos bëjnë ndërhyrje kirurgjikale në moshë të vogël, ai nuk njihet nga Gjendja Civile, e cila njih veç termat 'mashkull' dhe 'femër'²⁰.

Në këtë kuadër, vlerësojmë bashkëpunimin e iniciuar përgjatë vitit 2019 nga organizata TLAS me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe personelin mjekësor, të cilët janë duke punuar aktualisht mbi një draft të protokollit mjekësor lidhur me personat interseks, i cili synon synon të rregullojë situatën e ndërhyrjeve jokonsensuale dhe të panevojshme mbi fëmijët interseks.

Nga ana tjetër, vlen të theksojmë, se mosadoptimi i propozimit të depozituar nga Ambasada Pink dhe CRCA Shqipëri në Prill 2019 lidhur me ndalimin e procedurave mjekësore të panevojshme dhe jokonsensuale mbi foshnjat interseks²¹ dhe mospranimi i rekomandimit mbi ndalimin e procedurave kirurgjikale jo konsensuale dhe të panevojshme mbi foshnjat interseks, në kuadër të procesit të Rishikimit të Përgjithshëm Periodik në Maj 2019, nuk janë në një linjë me përsheptimin e arritjes së Objektivit 3 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, pasi faktojnë mënjanimin e personave interseks nga mbrojtja e nevojshme ndaj rrezikut të sigurt që paraqesin kirurgjitë jokonsensuale.

Një tjetër problematikë e vënë re nga dëshmitë e mbledhura nga anëtarët e komunitetit LGBTI+, lidhet me të drejtën e grave lesbike apo biseksuale për t'ju nënshtruar procedurave të riprodhimit mjekësor të asistuar, si prindër të vetëm. Ligji shqiptar për shëndetin riprodhues, në nenin 10 të tij sanksionon të drejtën e çdo individi dhe/ose çifti për të përfituar nga aplikimi i metodave të përballeshme dhe të pranueshme të planifikimit familjar. Më tej në nenin 30 të po këtij ligji sanksionohet specifikisht e drejta e çdo individi dhe/ose çifti për t'iu nënshtruar riprodhimit mjekësor të asistuar për të patur fëmijë²².

Nga dëshmia e një anëtareje të komunitetit, në funksion të këtij raportimi, duket se personeli mjekësor është hezitues në aplikimin e metodave të riprodhimit mjekësor të asistuar për individët, të cilët përmes paragjykitimit i perceptojnë si pjesë e komunitetit LGBTI+, duke cënuar të drejtat e tyre për të patur fëmijë dhe për të marrë shërbime të shëndetit riprodhues, çka prek në vetvete përmbushjen e targetit 3.5 të Objektivit 3 të Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Dëshmi 3: Ne kishim kohë që po mendonim të realizonim procedurën IVF dhe ju drejtua Klinikës X, ku na priti vetë mjeku O.G sëbashku me 2 mjekë të tjerë të rinj. Së pari, mjeku iu drejtua partneres sime duke e pyetur kush ishte. Ajo iu përgjigj se ne ishim shoqe dhe thjesht po më shoqëronte atë ditë në klinikë. Mjeku u drejtua nga 2 mjekët e tjerë dhe u kërkoi të dilnin nga salla. Më pas mu drejtua mua duke më pyetur nëse kisha një partner. Ju përgjigja se doja të lindja fëmijën tim si një nënë e vetme. Ai mu përgjigj se nuk mund t'i nënshtrohesha procedurës nëse nuk kisha një partner, pasi po përpiqej të shmangte abuzimet që mund t'u dhurojnë fëmijë burrave që janë në marrëdhënie me burra dhe grave në marrëdhënie me gra.

²⁰<https://www.reporter.al/femijet-interseks-ne-shqiperi-perballen-me-nderhyrje-kirurgjikale-te-panevojshme/>

²¹ILGA Europe (2020); Raporti për Shqipërinë.

²²Ligj Nr.8876/2002 "Për Shëndetin Riprodhues"

Një tjetër problematikë e komunitetit LGBTI+, lidhet me nivelin e informacionit në kuadër të edukimit shëndetësor. Ligji "Për Shëndetin Riprodhues"²³, në nenin 12 të tij sanksionon se çdo individ ka të drejtën për edukim shëndetësor, e cila përfshin mundësinë për t'u informuar dhe edukuar në fushën e të drejtave riprodhuese dhe seksuale dhe që nuk mund të kufizohet nga influenca e fesë, filozofisë, kulturës apo ideologjisë. Edhe në nenin 13 të Ligjit për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it²⁴ parashikohet detyrimi i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë për të përfshirë në kurrikulat shkollore informacione lidhur me parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it.

Nga pyetësi i realizuar me anëtarët e komunitetit, ku më shumë se 81% e të përgjigurve u shprehën se tekstet shkollore nuk përmbanin asnjë informacion lidhur me shëndetin seksual apo riprodhues të personave LGBTI+, por edhe nga informacionet e mbledhura mbi kurrikulat aktuale na rezulton, se kurrikulat e edukimit nuk përfshijnë asnjë informacion mbi shëndetin seksual dhe problematikat specifike të individëve LGBTI+, duke sjellë një mungesë të theksuar në informacionet e personave LGBTI+ në krahasim me individët heteroseksuale cisgjnorë. Kjo mungesë informacioni i vendos individët LGBTI+ para një risku më të lartë prekjeje nga sëmundjet dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme dhe sjelljeve të rrezikshme seksuale.

Gjatë dy viteve të fundit, Aleanca LGBT ka realizuar testime falas lidhur me HIV/AIDS-in për 303 persona LGBTI+. Kjo iniciativë mbart një rëndësi të jashtëzakonshme për individët LGBTI+, të cilët ndjehen më të sigurt duke e zhvilluar testimin në një mjedis paqësor dhe pa patur frikën dhe ankthin e diskriminimit nga ana e personelit mjekësor në qendrat shëndetësore. Ndërkohë, siç theksohet edhe në raportin e ILGA Europe për Shqipërinë, mungesa e mjekimeve retrovirale mbetet ende një problem evident²⁵. Për vite me radhë, Shqipëria nuk i blen dhe importon në kohën e duhur barnat e nevojshme retrovirale, që u nevojiten në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë pacientëve me HIV, të cilët gjatë periudhave ku barnat mungojnë detyrohen të ndryshojnë skemat e trajtimit, në dëm të shëndetit dhe cilësisë së jetës. Pavarësisht rolit proaktiv të organizatave të shoqërisë civile në ngritjen e kësaj problematike situata përsëritet nga viti në vit. Përveç mungesës së barnave retrovirale për periudha shumë të gjata kohore, individët me HIV përballen edhe me mungesën e testimeve CD4 lidhur me ngarkesën virale dhe rezistencën e virusit, çka i detyron t'i kryejnë testet me kosto tepër të larta pranë klinikave private. Aktivitetet e organizuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me ndërgjegjësimin ndaj HIV/AIDS-it mbeten inekzistente, çka ndikon në përforcimin e paragjykimeve dhe stigmas ndaj të prekurve me HIV. Kjo qasje shoqërore shtyn shumë persona të mos testohen ose të refuzojnë trajtimin, gjë që shkakton komplikime serioze shëndetësore dhe madje edhe vdekje. Edhe pse Shqipëria cilësohet si një vend me prevalencë të ulët ndaj virusit, numri i vdekjeve të lidhura me HIV në vend është alarmant, ku gjatë vitit 2018 vdiqën 27 persona, kurse gjatë 2019-ës 24 persona. Individët LGBTI dhe HIV+, mbeten kategoria më e afektuar nga diskriminimi për shkak të statusit HIV+, duke qenë subjekte të stigmës së dyfishtë, frikës së diskriminimit dhe përjashtimit²⁶.

²³Ligji Nr. 8876/2002 "Për shëndetin riprodhues"

²⁴Ligji Nr.9952/2014 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS-it"

²⁵ILGA Europe (2020); Raporti për Shqipërinë.

²⁶<https://www.lgbti-era.org/news/shocking-and-unacceptable-2020-albania-fails-its-hiv-aids-fight>

Nga ana tjetër, nga pyetësi i realizuar me persona LGBTI+, në kuadër të këtij raportimi më tepër se 11% e pjesëmarrësve u shprehën se nuk kishin patur mundësi të aksesonin shërbimet mjekësore që u ishin nevojitur ose që i kishin aksesuar ato vetëm pasi ishin paraqitur të shoqëruar nga persona të tjerë. Nga afro 88% e pjesëmarrësve, të cilët u shprehën se kishin marrë shërbime mjekësore gjatë viteve të fundit, 12 % e tyre u shprehën se kishin hasur diskriminim nga ana e personelit mjekësor gjatë vizitave të tyre, ndërsa 19% e tyre u shprehën se nuk ishin ndjerë komodë gjatë marrjes së shërbimeve për shkak të ndjenjës së frikës dhe ankthit se do të diskriminoheshin, paragjykoeshin apo edhe dhunoheshin në mjediset e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

Sa u përket vizitave të shëndetit seksual dhe riprodhues, 64% e pjesëtarëve të komunitetit të anketuar u shprehën se gjatë 4 viteve të fundit nuk kishin kryer vizita të tilla dhe/ose i kishin shmangur ato me qëllim edhe pse mendonin se u nevojiteshin për shkak të frikës se do të përballeshin me moskuptime nga ana e personelit, frikës mbi ruajtjen e konfidencialitetit, por edhe për shkak të gjendjes së tyre ekonomike.

Rreth 20% e të anketuarve janë shprehur se vuajnë nga patologji të përhershme apo nga sëmundje kronike, të cilat bëjnë që t'u nevojitet të vizitojnë institucionet shëndetësore më shumë se 7 herë në vit, çka i bën një target më të shpeshtë të diskriminimit potencial apo dhunës me të cilën përballen në këto ambiente.

Nisur nga sa më sipër, në përfundim mund të themi se personat LGBTI+ në kontekstin shqiptar hasin në pengesa të konsiderueshme drejt aksesimit dhe marrjes së shërbimeve bazike mjekësore dhe se statusi i tyre LGBTI+, i cili shpesh u mbivendoset vështirësive të tjera i bën subjekte vulnerabël të diskriminimit të shumëfishtë, paragjykit dhe dhunës në cënim të të drejtave dhe lirive të tyre themelore, duke sjellë nevojën urgjente të marrjes së masave specifike drejt realizimit të Objektivit 3 të Zhvillimit të Qëndrueshëm brenda vitit 2030.




Objektivi 4, i cili lidhet me sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës, është një nga më të rëndësishmit për t'u trajtuar në kuadër të këtij raportimi, pasi prek edukimin si një aspekt vital të jetës së çdokujt. Kemi zgjedhur të përqëndrohemi te targeti 4.5 i këtij objektivi, që lidhet me krijimin e mundësive për akses të barabartë në të gjitha nivelet e edukimit për fëmijët në situatë vulnerabël dhe te targeti 4.7, i cili nxit një sistem edukimi ku promovohet kultura e paqes, mos-dhunimit dhe respekti për të drejtat e njeriut.

Anëtarët e komunitetit LGBTI+, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehive dhe karakteristikave të seksit, të cilat vijnë në kundërshtim me mendësinë heteronormative dhe mentalitetin kulturor, targetohen në mjediset shkollore nga stafi akademik dhe rrethi social. Ky targetim sjell në të shumtën e rasteve pasoja mjaft negative, duke nisur nga presioni, dhuna psikologjike, bulizmi e deri te dhuna fizike dhe vendimet për të ndërprerë arsimimin për shkak të diskriminimit.

Siç përshkruet edhe në raportin e ILGA Europe mbi Shqipërinë, bulizmi dhe diskriminimi në ambientet e edukimit vijnë të jenë mjaft të përhapura në Shqipëri, ku mungojnë politikat specifike që mbrojnë nxënësit LGBTI+²⁷ Mungesa e këtyre politikave dëshmohet edhe nga rasti i vitit të kaluar ku një nxënës LGBTI+, në një Gjimnaz në Vlorë shtyhej, fyhej dhe dhunohej në mënyrë të përsëritur nga shokët e klasës pasi kishte dalë hapur lidhur me statusin e tij si LGBTI+. Të vetmet masa të marra nga drejtuesit e shkollës ishin ta lejonin të rrinte në dhomën e sanitareve gjatë pushimit të madh me qëllim që të mbrohej. Autoritetet e gjimnazit nuk e raportuan asnjëherë rastin në Polici dhe si përfundim i mituri e braktisi shkollën. Në kuadër të ngjarjes, Streha LGBT dëshironte të zhvillonte një trajnim me psikologët e shkollave lidhur me çështjet LGBTI+, por Ministria e Arsimit refuzoi t'i mundësonte lista me të dhënat e psikologëve.

Nëse flasim për situatën e dy viteve të fundit, gjatë vitit 2018, nga 421 raste të dhunës dhe diskriminimit të raportuara pranë Aleancës LGBT, 25% e tyre kanë ndodhur në mjediset e institucioneve arsimore. Sa i përket vitit 2019, pranë Aleancës LGBT janë raportuar 304 raste të dhunës (psikologjike, fizike dhe seksuale) nga individë LGBTI+, nga ku 50% e rasteve kanë raportuar dhunë sistematike dhe jo episodike. Siç tregohet edhe në tabelë, mjedisi shkollor dhe ai universitar mbeten ato ku raportohet se kanë ndodhur pjesa më e madhe e rasteve të dhunës, çka e bën situatën tejet shqetësuese.

Vendi në të cilën ka ndodhur dhuna:



Nisur nga fakti se bulizmi dhe diskriminimi mbeten ndër problemet prevalente për të rinjtë LGBTI+ dhe se informacioni në kurrikulat shkollore mungon tërësisht, çka sjell një kuptim tejet të kufizuar të rrethit social në shkollë, si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjimore 2016-2020, Ministria e Arsimit, Bashkia e Tiranës dhe Aleanca LGBT ndërmorën iniciativën e zhvillimit të një serie takimesh në shkollat publike në mars 2018. Iniciativa kishte si qëllim eliminimin e diskriminimit bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor si dhe zbutjen e stereotipeve të zakonshme gjinore.

²⁷ILGA Europe (2020); Raporti për Shqipërinë.

Fushata sensibilizuese u përball me një reagim të fortë dhe agresiv në median audiovizive dhe në mediat sociale, çka përbënte gjuhë të hapur urrejtjeje ndaj komunitetit LGBTI+, përfshirë atë të iniciuar nga zyrtarët publikë. Deputetë të Parlamentit Shqiptar e quajtën iniciativën si një "revoltë". Pas këtyre qëndrimeve, një program i mirënjohur televiziv nënçmoi iniciativën mes humorit banalizues dhe fyes për anëtarët e komunitetit. Ministria e Arsimit fillimisht mohoi se ishte pjesë e iniciativës dhe se kishte mbështetur zhvillimin e aktiviteteve dhe pas disa kohësh pranoi që aktivitetet ishin autorizuar nga Ministria, por vetëm si një projekt pilot.

Aleanca LGBT i dërgoi një letër publike Kryeministrit, duke i kërkuar atij të dënonte gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI+, por nuk pati asnjë reagim zyrtar. Lidhur me çështjen munguan edhe deklaratat zyrtare nga Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Si rezultat, Ministria e Arsimit vendosi të ndalojë aktivitetet e mëtejshme në shkollë²⁸. Edhe pse një seri aktivitetsesh sensibilizuese me në fokus sistemin arsimor dhe kurrikulat akademike kanë qenë objekt i Planit Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI 2016-2020, ato vijojnë të mbeten të paimplementuara, pasi procesi u bllokua me incidentin e 2018-ës, duke u pamundësuar plotësisht organizatatve LGBTI+ aksesin në instituconet arsimore.

Nga rezultatet e pyetësorit të realizuar në funksion të këtij raportimi, vetëm 6% e të anketuarve e cilësuan mjedisin shkollor shqiptar si të sigurt në raport me individët që u përkasin grupeve vulnerabël, ndërkohë që më tepër se 54% e të anketuarve e cilësuan atë si shumë të pasigurt.


Edhe pse vitet e fundit, në kuadër të përmbushjes së objektivave të Planit Kombëtar të Veprimit lidhur me personat LGBTI, ka patur përpjekje drejt trajnimit të stafit arsimor, rreth 60% e të anketuarve shprehen me bindje se mësuesit dhe drejtuesit e institucioneve arsimore nuk janë të informuar mbi çështjen LGBTI+. 34% e të anketuarve shprehen se nuk mund të përgjigjen me siguri, pasi ka vite që nuk janë në kontakt me mjediset arsimore, ndërkohë që vetëm në 6% të rasteve tregohet se mësuesit janë të informuar në lidhje me çështjen.

Për shkak të bulizmit, diskriminimit, stigmës dhe presionit social në harkun kohor të pesë viteve të fundit, vetëm pranë Aleancës LGBT janë raportuar 14 raste, ku personat LGBTI+ kanë ndërprerë edukimin përfundimisht dhe/ose për një kohë të caktuar mbi 2-vjeçare. Në 5 nga rastet e raportuara individët kanë ndërprerë edhe trajnimin sportiv.

77% e të anketuarve u shprehën se nuk kishin raportuar asnjëherë diskriminimin, bulizmin apo dhunën në strukturat përkatëse brenda institucionit të tyre arsimor, ku ndër shkaqet kryesore të mos raportimit cilësohen frika se nuk do të ruhej anonimati dhe frika se do të diskriminoheshin nga drejtuesit.

²⁸ILGA Europe (2020); Raporti për Shqipërinë.


A jeni ankuar ndonjëherë në organet brenda shkollës nëse jeni përballur me paragjykim/diskriminim/dhunë?



12.5% e të anketuarve janë shprehur se personalisht e kishin pasur të vështirë të aksesonin institucionet e arsimit profesional dhe gjimnazet për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor apo karakteristikave të seksit, ndërkohë që rreth 54% janë shprehur se njohin minimalisht një person tjetër që nuk ka mundur të aksesojë këto shërbime për shkak të statusit LGBTI+.

78% e personave LGBTI+ të anketuar janë përgjigjur se në kurrikulat shkollore të ciklit të detyrueshëm dhe të arsimit të mesëm nuk ka informacion lidhur me çështjet LGBTI+, ndërkohë që rreth 18% janë shprehur se nuk kanë informacion.

A përmbanin tekstet shkollore informacion të paanshëm lidhur me çështjet LGBTI+ dhe/ose edukim seksual të posaçëm për anëtarët e këtij komuniteti?



Nga kërkimi në kurrikulat ekzistuese, na rezulton se nuk ka informacione të vlefshme dhe edukative për komunitetin LGBTI+. Kur trajtohen tema të edukimit seksual, sa u përket sëmundjeve seksualisht të transmetueshme apo zhvillimit seksual, ato trajtohen nga një perspektivë heteronormative, çka bën që individët LGBTI+ të dalin nga sistemi arsimor me informacione të cunguara lidhur me problematikat specifike që prekin ata vetë.

Vihet re, se edhe kur përmendet komuniteti LGBTI+, kryesisht në kurrikulat universitare, këto citime përmbajnë konotacione të dyzuara dhe që përforcojnë stereotipet shoqërore, si psh. përmendja e homoseksualitetit sa herë flitet për HIV, si dy problematika që shkojnë në të njëjtën linjë, përforcimi i idesë se prijet e ndryshme seksuale dhe identiteti i ndryshëm gjinor shkojnë përkundër normalitetit dhe përforcimi i stereotipeve në përgjithësi.

- A përdorin kondom individët kur kryejnë marrëdhënie seksuale?
- Adoleshëntët: pjesa më e madhe e tyre nuk përdorin kondom dhe janë risk për SST. është shtuar numri i adoleshentëve të prekur nga sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- Homoseksualët: ëeatherburn et al. përdorimi i kondomeve është i lidhur me marrëdhëniet rastësore. megjithatë, brenda këtij grupi me një risk tepër të lartë, përdorimi i kondomeve është tepër i ulët.
- Biseksualët: ata shikohen si një urë lidhëse ndërmjet homoseksualëve dhe heteroseksualëve, e megjithatë përdorimi i kondomeve është mjaft i ulët.



(Slide nga një leksion i mbajtur në një Universitet në Shqipëri, ku përforcohen stereotipet mbi biseksualët)

Mungesa e informacionit të saktë dhe të paanshëm lidhur me komunitetin LGBTI+, duke theksuar sidomos mungesën e edukimit specifik lidhur me shëndetin seksual, kontribuon në rritjen e nivelit të moskuptimit dhe stereotipizimit që shoqëria shqiptare shfaq në përgjithësi ndaj komunitetit.

Nëse shohim në brendësi të parashikimeve të 2 Planeve Kombëtare të Veprimit LGBTI+, mbi implementimin e të cilave do të flasim më gjerësisht në kuadër të Objektivit 10, sanksionohet objektivi i reduktimit të diskriminimit ndaj komunitetit LGBTI+ përmes rishikimit të kurrikulave të të gjitha niveleve të sistemit arsimor si dhe përmes trajnimit të stafit arsimor. Nga raporti i monitorimit të implementimit të Planit Kombëtar të Veprimit për periudhën 2016-2020, rezulton se të vetmet hapa pozitive janë bërë në drejtim të trajnimit të stafit arsimor, ndërkohë që nuk ka progres sa u përket kurrikulave shkollore.

Lidhur me sa më sipër, vlerësojmë se bulizmi, diskriminimi, dhuna, cilësimi i mjedisve shkollorë si të pasigurta për personat LGBTI+, mungesa e qasjeve realiste ndaj problematikave të rinjve LGBTI+ në kurrikulat e edukimit, të cilat vijnë të mbeten të pa azhornuara me informacion (rikujtojmë se Shqipëria, në kuadër të Procesit të Rishikimit të Përgjithshëm Periodik nuk e pranoi rekomandimin mbi azhornimin e kurrikulave të edukimit për të paktën 4 vitet e ardhshme), numri i ulët i raportimeve të rasteve të diskriminimit dhe dhunës në autoritetet brenda shkollës dhe mentaliteti i rrethit social prekin të drejtën e individëve LGBTI+ për arsimim cilësor dhe gjithëpërfshirës. Ky fakt ndikon në një nivel më të ulët edukimi në radhët e komunitetit dhe në adoptimin e sjelljeve të rrezikshme dhe të paimformuara seksuale, duke u ndërlidhur me aspekte si mirëqenia e ulët fizike e psikologjike apo predispozita për shifra të larta të të papunëve potencialë LGBTI+.

Përmbushja e objektivit 4 të zhvillimit të qëndrueshëm brenda vitit 2030 pa lënë mënjanë personat LGBTI+, sjell nevojën për marrjen e masave specifike dhe transformuese drejt implementimit korrekt dhe real të legjislationit mbi mbrojtjen nga diskriminimi dhe Planit Kombëtar të Veprimit.



Ky objektivi do të trajtohet në kuadër të raportimit tonë nga perspektiva e grave dhe vajzave LGBTI, duke u mbështetur në targetet 5.1 dhe 5.2, të cilat parashikojnë detyrimet pozitive të shteteve për të eliminuar çdo lloj diskriminimi dhe dhune ndaj vajzave dhe grave. Nën frymën e Agjendës 2030, ku parashikohet se askush nuk përjashtohet nga mbrojtja që ofrojnë objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, kur flasim për të gjitha vajzat dhe gratë anembanë botës, nuk mund të përjashtojmë nga ky spektër ato LGBTI.

Në Shqipëri, sidomos gjatë viteve të fundit, dhuna dhe diskriminimi me bazë gjinore po bëhen gjithnjë e më evidente, duke u nisur nga numrat e larta të vrasjeve dhe dhunës së ushtruar në kontekstin familjar. Brenda harkut kohor të një viti në Shqipëri lëshohen nga gjykatat më tepër se 4000 Urdhëra Mbrojtjeje (UM) dhe Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtjeje (UMM) për gratë dhe vajzat ndaj dhunuesve të tyre²⁹.

Gratë lesbike, biseksuale dhe transgjimore, për shkak të orientimit të tyre seksual dhe/ose identitetit gjinor, por edhe për shkak të gjinisë së tyre janë subjekte të diskriminimit të shumfishtë, në një shoqëri ku koncepti i gjinisë, i nxitur nga kultura dhe mentaliteti është tejet binar dhe i mbështetur mbi role të mirëpërcaktuara dhe mbi stereotipe të sjelljes dhe paraqitjes femërore e mashkullore³⁰. Çdo devijim nga rolet, paraqitja dhe pritshmëritë mbi sjelljet në bazë të mentalitetit patriarkal, bën që individit të perceptohet si një qenie moralisht e gabuar. Në një studim mbi perceptimet shoqërore ndaj komunitetit LGBTI+, citohet se shqiptarët kanë një qëndrim tejet negativ dhe konservator, të bazuar në stereotipe heteronormative, ku ideja që duket se nuk e pranojnë asesi është ajo e prindërimit nga personat e komunitetit.

48% e publikut shqiptar mendon se homoseksualiteti është sëmundje dhe 42% mendojnë se personat homoseksualë duhet të kurohen³¹.


²⁹<https://www.crca.al/sq/news/shqiperi-mbi-100-gra-dhe-vajza-te-vrara-ne-18-vjet>

³⁰Pyetësor mbi opinionin publik lidhur me çështjet LGBTI.

³¹Ibid.

Në pyetësonin e krijuar për qëllimet e raportimit tonë, pjesëmarrëset LGBTI u pyetën nëse ndiheshin në përgjithësi të sigurt në Shqipëri dhe nga përgjigjet e dhëna rezulton se 82% e tyre nuk ndihen absolutisht të sigurt.

Si vajzë/grua LGBTI+, a ndjehesh e sigurt në Shqipëri?



Ndër çështjet që i shqetësonin më tepër, ato renditën mungesën e një baze juridike për njohjen e identitetit gjinor, mungesën e pavarësisë për shkak të statusit ekonomik, diskriminimin me bazë gjinore, dhunën në hapësirat publike dhe dhunën seksuale, edukimin e kufizuar dhe martesat e detyruara. Nisur nga raportimet e dy viteve të fundit rezulton, se gjatë vitit 2018, 285 nga 421 raste të dhunës fizike, psikologjike dhe seksuale të regjistruara u përkasin vetëm vajzave dhe grave LGBTI, ku kategoria më e prekur mbetet ajo e transgjinoreve me 125 raste të raportuara vetëm pranë Aleancës LGBT. Sa i përket vitit 2019, rezulton se grave LGBTI u përkasin 206 nga 304 raste të dhunës të raportuara në total, ku gratë transgjinore vijnë të jenë kategoria më e prekur. Vlen të theksojmë në këtë linjë, rastin e gruas transgjinore, e cila u dhunua nga 5 burra pas paradës së lesbikeve që u mbajt në Tiranë në Nëntor 2019. Të gjitha organizatat partnere në rajon e dënuan aktin dhe Presidenti i Republikës bëri thirrje për nxjerrjen përpara drejtësisë së dhunuesve.

Mirëpo, që nga muaji nëntor nuk ka rezultate konkrete të hetimit të nisur, ku gojarisht vijon të thuhet se nuk ka shumë shpresa për gjetjen e dhunuesve pasi kamerat në zonë nuk punonin, ndërkohë që flasim për një zonë qendrore të qytetit. Sa herë u kërkohet një version i shkruar për përgjigjen që kthejnë punonjësit e Policisë refuzojnë ta japin atë. Nëse marrim parasysh përgjigjen e fundit lidhur me rastin, ku nga Institucioni i Avokatit të Popullit, mes një gjuhe diskriminuese adresohet gruaja transgjinore në fjalë, nga shkresa e Policisë rezulton se kamerat në zonë punonin dhe se pasi pamjet ishin kontrolluar gruaja në fjalë nuk ishte parë të dhunohej nga askush, ndërkohë që ekspertiza mjekoligjore faktori dhunën. Nga kontradiktoriteti i përgjigjeve të dhëna nga institucione të ndryshme publike, refuzimi për të lëshuar një version të shkruar të përgjigjes nga Policia e Shtetit dhe nga mënyra se si është trajtuar institucionalisht çështja, janë të gjitha gjasat që të ndodhemi para një hetimi joefektiv.

Në vijim, nga rezultatet e pyetësorit 35% e pjesëmarrëseve u përgjigjën se nuk konsideronin të kishin akses të plotë dhe të lirshëm në shërbimet e kujdesit shëndetësor seksual dhe riprodhues, ku si shkakun kryesor identifikuan mungesën e informacionit nga ana e mjekëve, sistemin imponues gjinor dhe mentalitetin patriarkal si edhe faktin që mjekët nuk pranojnë të ofrojnë shërbim ndaj grave që i perceptojnë si LBT, sidomos kur ato paraqiten të pashoqëruara.

Pjesëmarrëset në pyetësor u përgjigjën se kanë hasur vështirësi në procedurat e rekrutimit dhe punësimit, ku në 47% të rasteve vlerësuan si shkaqe kryesore orientimin seksual, identitetin e tyre gjinor dhe pamjen e jashtme që nuk përkon me standardet e sistemit të ngurtë gjinor.

Sa i përket nivelit të tyre të informacionit mbi të drejtat dhe liritë që u garantohen ligjërisht, afro 40% e pjesëmarrëseve shprehën se nuk kanë dijeni që punëdhënësit janë të detyruar të respektojnë klauzolat e Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi, i cili ka 10 vite që ka hyrë në fuqi.

Në kuadër të situatës familjare, me të cilën duket se gratë LGBTI përballen vlen të theksojmë se prindërit shqiptarë që janë në dijeni të identitetit të tyre gjinor apo orientimit seksual, u bëjnë presion që të mos shfaqen në publik si LGBTI, nga frika e opinionit të të afërmeve dhe shoqërisë, por edhe nga frika se do të bien pre e paragjytimeve dhe diskriminimit për pasojë, çka reflektohet edhe në studimin e kryer mbi perceptimet shoqërore ndaj komunitetit, ku 76% e popullatës së zgjedhur mendon se personat LGBTI duhet të përpiqen ta fshehin orientimin seksual dhe identitetin gjinor në mënyrë që të mos çenojnë "nderin" e vetes, familjarëve dhe miqve të tyre³². Kur flasim për personat transgjinorë, këto qëndrime janë tejet rigorozë, pasi identiteti i tyre i ri gjinor perceptohet si zgjedhje personale. Në raportin BLEE³³ theksohet se lesbiket dhe transgjinorët përfjethen nivelet më të larta të dhunës në familje, por nga ana tjetër përbëjnë kategoritë më të prirura për të mos e raportuar atë edhe pse të gjitha këto akte të kryera mbi bazat e OSIGJ kriminalizohen nga parashikimet e Kodit Penal në fuqi. Në raportin e ILGA Europe të vitit 2016, shprehet qartë fakti se dhuna në familjen shqiptare përbën një çështje problematike dhe shqetësuese për gratë lesbike³⁴.

Nisur nga faktet e sipërcituara, theksojmë nevojën për mbrojtje juridike shtesë nga ana e shtetit shqiptar në drejtim të grave dhe vajzave LGBTI, sidomos lidhur me procedurat e referimit të rasteve dhe raportimet e tyre, si edhe marrjen e masave efektive drejt krijimit të mundësive juridike për akses në procedurat e terapi së hormonale dhe kirurgjive të nevojshme për personat transgjinorë. Objektivi 5 i Zhvillimit të Qëndrueshëm, nuk mund të arrihet në mënyrë të përsheptuar duke lënë mënjanë gratë dhe vajzat LGBTI.

³²Ibid.

³³Ligj Nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"

³⁴UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

8 PUNË DINJTOZE DHE RRIJJE EKONOMIKE



Objektivi 8 parashikon nxitjen e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme si edhe punësimin dhe të drejtën e kujtëdo për punë të denjë. Për raportimin tonë kemi zgjedhur të fokusohemi te targeti 8.5, i cili parashikon punësimin e plotë dhe produktiv për të gjitha gratë dhe burrat si dhe personat e rinj si edhe te targeti 8.8 që fokusohet te mbrojtja e të drejtave të punës dhe te promovimi i ambienteve të sigurta të punës për të gjithë punonjësit.

E drejta për të fituar të ardhurat mes punës së ligjshme është një nga ato më prezentet dhe më të rëndësishmet në jetën e kujtëdo. Homofobia, bifobia dhe transfobia, të cilat janë prezente në realitetin shqiptar, ku ende 76% e publikut mendon se të jesh LGBTI do të thotë se vuan nga një sëmundje patologjike³⁵, afektojnë realizimin e kësaj të drejte të anëtarëve të komunitetit, duke sjellë nevojën e marrjes së masave specifike në përm-bushje të objektivit 8. Diskriminimi, bulizmi dhe braktisja e shkollës, izolimi social, vetëbesimi i ulët dhe gjendja e rënduar psikologjike e individëve LGBTI, ku duket se më të afektuarit janë personat transgjnorë, ndikojnë në një nivel të ulët edukimi në radhët e komunitetit, çka në vijim kthehet në barrierë për të aksesuar tregun e punës, duke pamundësuar pavarësinë ekonomike. Këto faktorë janë shpesh shkak për shumë nga anëtarët e komunitetit transgjnor drejtohen nga puna e seksit, e cila duke qenë se është e kriminalizuar në Shqipëri i vendos përpara rreziqeve të larta potenciale për diskriminim, dhunë apo trafikim, pasi e shohin si zgjidhjen e vetme për mbijetesë. Nëse flasim për situatën e viteve të fundit, 19 persona të komunitetit transgjnor që frekuentojnë Aleancën për marrjen e shërbimeve ditore rezultojnë se punojnë si punonjëse seksi.

Vetëm në vitin 2018 pranë Aleancës LGBT janë drejtuar 74 persona të komunitetit, të cilët janë asistuar me elementet e nevojshme të një aplikimi pune si plotësimi dhe përditësimi i CV-ve, përgatitjet për intervistat e punës dhe ndërmjetësimi në zyrat e punësimit, ku vlen të theksohet se asnjë nga personat e referuar nuk mori ofertë punësimi përgjatë këtij viti³⁶. Nga ana tjetër, nga radhët e individëve të punësuar, gjatë 2018-ës vetëm pranë Aleancës LGBT janë raportuar 39 raste të diskriminimit në punë. Sa u përket përfituesve të shërbimeve të Strehës, gjatë viti 2018 ata kanë arritur të punësohen në 64 vende pune, ku në pjesën më të madhe të rasteve kanë patur vështirësi në krijimin e marrëdhënieve të qëndrueshme të punës për shkak të mjedisit diskriminues, mungesës së punëve të siguruara dhe kontratave të punës apo vështirësive emocionale.

Edhe për vitin 2019 duket se punësimi i të rinjve LGBTI ka mbetur një sfidë. Aleanca LGBT ka asistuar gjatë vitit 42 të rinj punëkërkues, me kërkesat e aplikimit, përgatitjen për intervistat, me ndërmjetësimin direkt në tregun e punës apo regjistrimin në kurse profesionale, në varësi të nevojave të tyre. Si rezultat i mbështetjes së vazhdueshme dhe ndjekjes së rasteve janë punësuar 5 të rinj të komunitetit, ndërkohë që vijuan të ishin prezente largimet nga puna për shkak të trysisë së punëdhënësve për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor të punëmarrësve. 37 anëtarë të komunitetit referuan diskriminimin dhe dhunën në ambientin e punës pranë Aleancës LGBT.

Dëshmi: 4 “Mendoj që dola mirë në intervistën e punës, iu përgjigja mirë pyetjeve dhe u kujdesa që të trash zërin dhe mos të kuptonin që jam gay”.


Dëshmi: 5 “Në periudhën e Paradës, në punë flitet shumë rreth orientimit seksual dhe identitetin gjinor, të dëgjosh nga kolegët dhe shefat sa me urrejtje flasin është e shumë e vështirë për mua, por pjesa më e rëndë është që unë nuk flas, nuk jap asnjë opinions’mundem.....më ikën zëri kur mendoj për pasojat”.

³⁵Ibid.

³⁶ILGA Europe (2016); Rishikimi i zgjerimit: Mbi Shqipërinë.

Nga të dhënat e mbledhura në kuadër të pyetësorit që realizuam në funksion të këtij raportimi, rezulton se vetëm 23% e të përgjigjurve janë ndjerë të sigurt në mjedisin e tyre të punës, ndërkohë 59% e pjesëmarrësve pohojnë nga ana tjetër se edhe pse nuk kanë dalë hapur si LGBTI+, sërish e kanë ndierë presionin dhe diskriminimin, çka përkon me kulturën e përhapur të paragjykitit që origjinet nga sjelljet dhe pamja që nuk përkojnë me modelet binare gjinore.

Sa të sigurt dhe të respektuar jeni ndjerë në punën tuaj?



Ndër shkaqet kryesore që të pyeturit kanë renditur si pengesa për të dalë hapur në mjedisin e punës përmendet frika për humbjen e vendit të punës, frika nga distancimi i kolegëve që punojnë në të njëjtin mjedis, frika nga dhuna që mund t'u ushtrohej, frika nga sanksionet administrative me të cilat mund të përballeshin, por edhe frika se mund të paguheshin më pak apo të shfrytëzoheshin jashtë orarit zyrtar në këmbim të tolerancës ndaj statusit të tyre LGBTI+. Faktorëve të frikës së sipërpërmendur u mbivendoset edhe fakti që shumica e individëve LGBTI+ nuk kanë dalë hapur lidhur me orientimin seksual apo identitetin gjinor të familjarët e tyre, çka bën që rastet të mos i raportojnë dhe ndjekin ligjërisht, pasi këto hapa do t'i detyronin të bënin publike të dhëna personale dhe sensitive.

Vlen të theksojmë se vitet e fundit janë bërë përmirësime të legjislacionit të punës në Shqipëri, në kuadër të mosdiskriminimit mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor, ku në rast shkeljeje të pretenduar punëdhënësi ka barrën e provës për të treguar se nuk ka shkelur parimin e trajtimit të barabartë të punonjësve. Sëbashku me Ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi kuadri ligjor për mbrojtjen e personave LGBTI+ në mjedisin e punës është cilësuar ndërkombëtarisht³⁷ si i plotë, mirëpo kur flasim për implementimin e të drejtave dhe detyrimeve të sanksionuara situata ndryshon, pasi edhe nga faktet e sipërpërmendura kuptojmë se individët LGBTI+, për shkak të rrethanave jofavorizuese sociale, kulturore dhe familjare janë në një shumicë të rasteve hezitues për të raportuar rastet e diskriminimit pranë institucioneve dhe organeve të pavarura.

³⁷UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

Të pyetur në kuadër të pyetësorit tonë, se ku do ta referonin më parë një rast diskriminimi më tepër se 52% e të përgjigjurve u shprehën se do t'i drejtoheshin Aleancës LGBT apo ndonjë OJQ-je tjetër dhe se nuk do të ndërmerrnin hapa të mëtejshëm ligjorë për të raportuar dhe ndjekur rastin.

Duke marrë parasysh rastet e larta të diskriminimit të raportuar pranë organizatave, ku vetëm një përqindje e ulët e tyre i drejtohen Komisionerit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe asnjë rast nuk është drejtuar në Gjykatë; numrin e lartë të të papunëve në radhët e komunitetit; ofertën e ulët për punë; nivelin e edukimit dhe situatën ekonomike të individëve LGBTI+, në mënyrë që të shkojmë drejt një përmbushjeje të shpejtë të Objektivit 8 të Zhvillimit të Qëndrueshëm është e nevojshme marrja e masave specifike, implementimi i plotë i Planit kombëtar të veprimit për personat LGBTI+, si dhe një trajtim i diferencuar në kuadër të parashikimeve juridike mbi punësimin.



Në kontekstin e objektivit 10 të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili synon të zvogëlojë pabarazitë në kontekstet e brendshme dhe ato ndërkombëtare të shteteve, do të fokusohemi te targetet 10.2 dhe 10.3, që parashikojnë fuqizimin dhe gjithëpërfshirjen sociale të kujtdo pavarësisht moshës, seksit, aftësisë së kufizuar, racës, etnisë, origjinës, fesë, statusit ekonomik dhe çdo statusi tjetër si edhe sigurimin e mundësive të barabarta për të gjithë mes draftimit dhe imlementimit të instrumentave juridike apo shfuqizimit të tyre kur defavorizojnë grupe të veçanta shoqërore.

Nga interpretimi literal dhe sistematik i targeteve dhe nga formulimi i këtij objekti, është e padiskutueshme nevoja e përfshirjes së një perspektive LGBTI+ në përpjekjet për të hedhur dritë mbi nivelin e implementimit të tij konkret, nga ana e shtetit Shqiptar.

Është fakt, se ligjet, politikat dhe praktikrat e ndryshme në implementimin e tyre ndikojnë drejtpërdrejt mbi situatën e subjekteve që targetojnë, por edhe në mendësinë e përgjithshme shoqërore, duke kontribuar në lehtësimin apo në përforcimin e qasjeve negative, stereotipike apo stigmatizuese, sidomos kur flasim për individë LGBTI+, të cilët shihen nga shoqëria ndër vite si të sëmurë patologjikë.

Shqipëria ka bërë padyshim hapa përpara sa i përket kuadrit ligjor, duke përmendur sidomos adoptimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku orientimi seksual dhe identiteti gjinor përmenden eksplicitisht si baza që legjitimojnë mbrojtjen nga diskriminimi; ndryshimet e Kodit të Punës lidhur me ndalimin e diskriminimit mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor; ndryshimet e Kodit Penal, ku në tri nene të tij përmenden orientimi seksual dhe identiteti gjinor si shkaqe të mjaftueshme, që kur motivojnë një vepër penale sjellin cilësimin e saj si të kryer në rrethana rënduese, në kuadër të shkëljes së barazisë së shtetasve si edhe në rastin e nxitjes së urrejtjes dhe grindjeve si edhe parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, ku përmendet eksplicitisht në kuadër të parimit të mosdiskriminimit baza e orientimit seksual dhe identitetit gjinor.

Pas rekomandimit CM/Rec(2010)5³⁸ të Komitetit të Ministrave të shteteve anëtare lidhur me masat për të luftuar diskriminimin mbi shkaqe të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, Shqipëria vijoi me adoptimin e Planit Kombëtar të Veprimit 2012-2014, i cili synonte forcimin e organizatave me në fokus personat LGBTI dhe të kontributit që jepnin në përmirësimin e jetës së personave LGBTI në Shqipëri. Implementimi i këtij plani gjatë viteve 2012-2014 mbeti një sfidë, pasi pati shumë pengesa dhe mungesa në implementimin dhe realizimin e objektivave dhe aktiviteteve të parashikuara, siç theksohet edhe në dokumentin e bashkëpunimit të Këshillit të Europës³⁹, lidhur me Shqipërinë.

Nisur nga mësimet e nxjerra nga implementimi i Planit të parë të Veprimit, u kryer disa reforma legjislative, të cilat prekën kryesisht legjislacionin penal dhe atë të punës, por në përfundim të periudhës së veprimit u konsiderua ekzistenca e një hendeku të madh në implementim në të gjitha nivelet, veçanërisht në ato rajonale dhe vendore, ku personat LGBTI+ vijnë të jenë objekt diskriminimi në jetën e përditshme. Në vijim, mbështetur nga ekspertiza e ekspertëve të Këshillit të Europës, Shqipëria punoi lidhur me një Plan Kombëtar Veprimi të ri për personat LGBTI+, i cili kësaj here kishte në objektiv legjislacionin, qasjen e politikave dhe ofrimin e shërbimeve për personat LGBTI+.

Plani i veprimit 2016-2020, pati në themel Udhërrëfyesin e Shqipërisë për trajtimin e 5 prioritetëve kyçë si pjesë e planit të anëtarësimit në BE ; Rezultatet e vitit 2014 të Rishikimit Periodik Universal të Këshillit të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë dhe rekomandimet e Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI) të vitit 2015. Tri qëllimet strategjike të planit ishin⁴²:

- (i) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe institucional dhe rritja e ndërgjegjësimit për mosdiskriminimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- (ii) Eliminimi i të gjitha formave të diskriminimit kundër komunitetit LGBTI;
- (iii) Përmirësimi i qasjes në shërbime: punësim, arsim, kujdes shëndetësor, strehim dhe shërbimet sportive për personat LGBTI, duke garantuar mundësi dhe të drejta të barabarta.

Sëbashku me këtë Plan Veprimi, gjatë vitit 2016 u krijua edhe trupa ndërmministrorë për implementimin dhe koordinimin e aktiviteteve të tij, e cila në bashkëpunim të ngushtë me palët kryesore të përfshira në zbatim, si Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Administrata Publike dhe personeli përgjegjës në ministritë e linjës, Zyrat e KMD dhe AP, deputetët e Kuvendit, punonjësit në fushat e arsimit,

³⁸Departamenti Ndërkombëtar i Standardeve të Punës (2019); Dokument Informues kundër diskriminimit mbi bazat e orientimit seksual, identitetit dhe shprehjes gjinore dhe karakteristikave të seksit.

⁴⁰Këshilli i Europës (2014); Dokumenti i Bashkëpunimit për Shqipërinë 2012-2014.

⁴¹Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, PKV 2016-2020.

⁴²Ibid.

kujdesit shëndetësor, rinisë, shërbimeve sociale dhe punësimit, OJQ-të kombëtare dhe ndërkombëtare me fokus personat LGBTI dhe të drejtat e njeriut, ekspertët vendorë dhe ndërkombëtarë⁴³, do të siguronte arritjen e objektivave të vendosura dhe realizimin e aktiviteteve të parashikuara.

2020-a përkon me vitin e fundit të implementimit të këtij Plani Veprimi, i cili meriton vëmendje të shtuar në kuadër të trajtimit të objektivit 10 të zhvillimit të qëndrueshëm, pasi për nga pikëpamja juridike përbën edhe dokumentin më të rëndësishëm në mbështetje të realizimit të mëtejshëm të të drejtave LGBTI+.

Nga monitorimi i kryer në vitin 2018 lidhur me implementimin e planit disa nga gjetjet kyçe, të cilat vijojnë të mbeten relevante, konsistojnë në faktin, se trupa kombëtare ndërministrorë për implementimin dhe koordinimin nuk ka kryer efektivisht rolin e saj zbatues dhe koordinues të aktiviteteve të parashikuara. Ministrinë e linjave dhe institucionet e tjera të përfshira në implementim nuk kanë krijuar mekanizmat e nevojshme për përfshirjen e çështjeve LGBTI në punën e tyre, duke theksuar si shkaqe mungesën e burimeve njerëzore, transferimet e shpeshta të stafit përgjegjës, mungesën e komunikimit brenda institucioneve, mungesën e koordinimit të nevojshëm, mungesën e buxhetimit dhe mungesën e njohurive dhe aftësive të administratës. Vihet re, se në aktet strategjike dhe planet e veprimit të hartuara gjatë periudhës 2016-2020 nuk ka referenca konkrete për personat LGBTI, orientimin seksual dhe identitetin gjinor, pavarësisht se në disa raste dokumentet mbulojnë aspekte të rëndësishme që ndikojnë në përmbushjen e objektivave të këtij Plani Kombëtar të Veprimit.

Gjatë periudhës 2016-2020, janë organizuar aktivitete nga organizata ndërkombëtare dhe lokale të shoqërisë civile, të cilat kanë qenë në një linjë me përmbushjen e objektivave të vetë planit për edukim dhe trajnim, mirëpo nismat e ngjashme, të ndërmarrë nga institucionet publike për të përsëritur këto lloj trajnimesh mbeten të kufizuara. Gjatë periudhës së implementimit nuk vihen re përmirësime dhe përditësime të kurrikulave me informacion mbi komunitetin LGBTI+ dhe po kështu nuk vihen re masa të ndërmarrë në kuadër të azilkërkuesve LGBTI+.

Në kontekstin e ofrimit të shërbimeve, i cili përbën prioritet për PKV-në, të vetmet hapa pozitive vihen re në kuadër të trajnimit të një numri të ofruesve të shërbimeve dhe të personave që janë pjesë e stafit të organizatave lokale, të cilat vijojnë të kenë problematika të konsiderueshme të mungesës së fondeve dhe mungesës së suportit institucional.

Edhe në dokumentin për Shqipërinë të Komisionit European lidhur me politikat e zgjerimit⁴⁴, theksohet se Planit të dytë Kombëtar të Veprimit për personat LGBTI i mungon buxheti dhe rezultatet e dukshme. Në dokument referohet edhe ndërgjegjësimi i ulët publik ndaj personave LGBTI+, veçanërisht në zonat rurale. Gjuha e urrejtjes dhe gjuha diskriminuese referohen në dokument si problematika mjaft evidente sidomos në median online, ku citohet edhe pjesëmarrja aktive e anëtarëve të Parlamentit Shqiptar në këto lloj aktesh. Komisioni thekson, se pavarësisht deklaratave të forta të bashkësisë ndërkombëtare ndaj këtyre rasteve flagrante, reagimi i institucioneve shqiptare mbetet i vakët.


⁴³UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

⁴⁴UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

Duke mbetur në linjën e krimeve të urrejtjes, nga të dhënat e regjistruara në databazën e Aleancës LGBT, gjatë vitit 2018 janë raportuar pranë organizatës 421 raste dhune dhe diskriminimi, nga të cilat vetëm 5 raste janë referuar pranë organeve kompetente. Nga 5 rastet e raportuara, 3 raste të dhunës janë referuar në Polici dhe 2 raste diskriminimi pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Asnjë nga 3 rastet e denoncuar nuk ka patur ndjekjen e duhur nga Policia, ndërsa anëtarët denoncues pohojnë, se gjatë kohës së kryerjes së denoncimeve janë përballur me tallje dhe ofendime prej punonjësve të Policisë. Në 2 nga 3 rastet e raportuara në Polici punonjësit kanë refuzuar dhënien e një kopjeje të proces-verbalit të mbajtur, në kuadër të detyrimit të tyre për transparencë dhe të drejtës së individëve për informim. Në 1 nga 3 rastet, denoncuesja e komunitetit transgjinnor është detyruar nga punonjesja e Policisë të tërhiqte denoncimin e kryer. Sa i përket vitit 2019, pranë Aleancës LGBT janë raportuar 304 raste dhune dhe diskriminimi, nga të cilat janë referuar në organet kompetente vetëm 34 raste, 5 nga të cilat e kanë raportuar dhunën te drejtuesi i institucionit ku ndodhi akti, 15 raste në Polici, 10 raste te Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe 4 raste te Avokati i Popullit. Nisur nga të dhënat e mëposhme, vetëm 4 nga rastet e raportuara në strukturat të shtetërore (12%) kanë marrë zgjidhje.


Në të njëjtën linjë me numrin e ulët të raportimeve shkojnë edhe përgjigjet e dhëna në kuadër të pyetësorit që zhvilluam me anëtarët e komunitetit në kuadër të këtij raporti, ku 85% e tyre u shprehën se nuk kishin fare besim te organet e rendit.

A besoni në Institucionet e rendit në Shqipëri?




91% e pjesëmarrësve pohuan, se nuk kishin raportuar asnjëherë dhunën ndaj tyre apo ndaj ndonjë anëtari tjetër të komunitetit pranë institucioneve shtetërore, ndërkohë që 60% e tyre u shprehën se nuk kishin njohuri mbi procedurat e referimit dhe për organin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

A keni raportuar ndonjëherë diskriminimin/dhunën e ushtruar ndaj jush apo ndaj një anëtari tjetër të Komunitetit në organet e policisë, te Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi apo tek Avokati i Popullit?



Të pyetur nëse kishin qenë pjesë e ndonjë trajnimit apo takimi të organizuar nga institucionet shtetërore, lidhur me legjisacionin kundër diskriminimit dhe të drejtat juridike të tyre, 79% e pjesëmarrësve u përgjigjën negativisht. 52% e pjesëmarrësve u përgjigjën, se në çdo rast dhune të drejtuar ndaj tyre apo ndaj ndonjë anëtari tjetër të komunitetit do të zgjidhnin t'i drejtoheshin Aleancës LGBT dhe jo organeve shtetërore.

Nëse do të gjendeshit përballë një situatë dhune apo diskriminimi, ku do të raportonit më parë:



COC Netherlands, Aleanca LGBT dhe Pro LGBT, në kuadër të nevojës së ofruesve të shërbimeve për më tepër trajnim dhe njohuri, zhvilluan gjatë 2019-ës trajnimin e trajnerëve me 40 policë të Akademisë së Sigurisë dhe dolën në përfundimin, se nevoja për trajnime të tilla mbetet mjaft e lartë, sidomos jashtë Tiranës, në një kohë ku rastet e krimeve të urrejtjes janë në rritje⁴⁵.

⁴⁵Raporti mbi Shqipërinë (2019); Dokumenti shoqërues i komunikimeve mes Komisionit, Parlamentit Europian, Këshillit, Komitetit Europian Ekonomik-Social dhe Komitetit të Rajoneve.

Gjatë 2019-ës, Pro LGBT dokumentoi një numër të lartë të incidenteve të gjuhës së urrejtjes ndaj personave LGBTI+, ku më të targetuarit ishin personat transgjjinorë. Në vijim, u zhvilluan disa trajnime për gazetarët lidhur me raportimin etik ndaj komunitetit LGBTI+, të cilat do të vazhdojnë të zhvillohen edhe gjatë 2020-ës. Nga studimi i kryer nga organizata rezultoi, se gjuha e urrejtjes e përdorur nga figurat politike pësoi një trend rritës gjatë 2019-ës, ku dy prej rasteve më flagrante u raportuan në Këshillin e Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Në rekomandimin e Komitetit për Të Drejtat e Njeriut të vitit 2013, u theksua nevoja e intensifikimit të përpjekjeve për të luftuar stereotipet dhe paragjykimet e publikut të gjerë ndaj personave LGBTI+ dhe nevoja e ofrimit të trajnimeve të përshtatshme për zyrtarët publikë, për t'i dhënë fund stigmatizimit shoqëror të personave LGBTI+. Rekomandimet theksojnë, se shtetet duhet të hetojnë efektivisht çdo pretendim për deklarata diskriminuese ndaj personave LGBTI+ nga zyrtarët publikë dhe të marrin masa të përshtatshme për të parandaluar deklarata të tilla në të ardhmen. 2 raportimet e kryera gjatë 2019-ës në Shqipëri, rezultuan vetëm në një paralajmërim për televizionin në fjalë, të cilit nuk ju vendos asnjë penaltet apo gjobë tjetër⁴⁶, në mënyrë joproporcionale me natyrën e agravuar të situatës.

Vlen të theksojmë mungesën e parashikimeve specifike, lidhur me krimet kibernetike, si nënkategori e krimeve që nxisin gjuhë urrejtjeje, diskriminuese dhe grindje ndaj personave LGBTI+. Nisur nga të dhënat e vitit 2018, anëtarët e komunitetit u shprehën se përfjethë dhunë të ushtruar mes mjeteve të teknologjisë, kryesisht në rrjetet dhe llogaritë e tyre sociale në masën 35.5% të totalit të rasteve të raportuara të dhunës dhe diskriminimit me bazë orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor⁴⁷.

Sa u përket ligjeve që do të përmirësonin jetën e anëtarëve të komunitetit LGBTI+, theksojmë se në Shqipëri nuk ekziston asnjë ligj që njeh partneritetet apo bashkëjetesën mes personave të të njëjtit seks, në shkelje të garancive kushtetuese, të cilat janë tepër të qarta sa i përket të drejtës së çdo shtetasi shqiptar mbi 18 vjeç për t'u lidhur në martesë. Mungesa e një parashikimi të tillë, sjell mjaft vështirësi praktike për çiftet gej dhe lesbike, të cilat gjenden në pamundësi juridike për të krijuar një regjim pasuror të përbashkët apo për të transferuar të drejta trashëgimore te njëri-tjetri, pavarësisht situatës së tyre faktike. Aktualisht çiftet të të njëjtit seks nuk u njihet e drejta për të pasur fëmijë as mes procedurave të riprodhimit të asistuar mjekësor as përmes procedurave të birësimit, ku në çdo rast sanksionohet vetëm e drejta e pasjes së fëmijëve sip rind i vetëm dhe jo si familje dy-prindërore. Në kuadër të procesit të Rishikimit të Përgjithshëm Periodik, gjatë vitit të kaluar Shqipëria hoqi dorë nga 5 rekomandime mbi marrjen e masave konkrete drejt një legjislacioni gjithëpërfshirës, i cili u krijon mundësinë çifteve gej dhe lesbike të lidhen në martesë apo të krijojnë një regjim bashkëjetese të rregulluar ligjrisht.

Nga jurisprudenca e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, rezulton se mungesa e parashikimeve juridike, në mënyrë të barabartë me ekzistencën e ligjeve diskriminuese ndikon në përkeqësimin e nivelit të realizimit të të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

⁴⁶ILGA Europe (2020); Raporti mbi Shqipërinë.

⁴⁷ILGA Europe (2020); Raporti mbi Shqipërinë.

Objektivi 10 i Zhvillimit të Qëndrueshëm nuk mund të arrijë spektrin e tij gjithëpërfshirës nëse nuk rregullohen në mënyrë të paanshme aspekte bazike të jetës së çdo individi, siç është e drejta për martesë apo bashkëjetesë të njohur ligjërisht, prandaj vlerësojmë se në këtë dekadë të fundit të implementimit të Axhendës 2030, nevojiten hapa të përshpejtuara dhe transformuese nga ana e shtetit shqiptar, që individët LGBTI+ të mos lihen nën garancive që u siguron objektivi në fjalë.

Nga ana tjetër, situata e personave transgjinorë është totalisht e parregulluar nga pikëvështrimi juridik dhe ai praktik, pasi mungesa e një ligji mbi njohjen e identitetit gjinor u pamundëson ndryshimin e gjinisë në dokumentet zyrtare, fakt që theksohet edhe në raportin e 2016-ës të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të sesionit të 64-t të CEDAW.

Nisur nga faktet që kemi përmendur në kuadër të trajtimit të objektivave 3,4,5 dhe 8, problematikat kryesore me të cilat ata ndeshen, si aksesimi në institucionet shëndetësore, braktisja e shkollës për shkak të diskriminimit, niveli i ulët i edukimit, vështirësitë në tregun e punës, vështirësitë ekonomike dhe ato të strehimit, bëjnë që të kemi një numër të lartë transgjinorësh të drejtuar nga puna e seksit, e cila vijon të jetë e kriminalizuar në Shqipëri. Për të adresuar situatën specifike të rrezikshme të punonjëseve transgjinorë të seksit dhe në bazë të rekomandimeve të CEDAW në raportin periodik të 2010-ës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në vitin 2012 rekomandoi dekriminalizimin e punës së seksit⁴⁸. Në vitin 2015, pas një rrugëtimi që çështja kaloi në Gjykatën e Lartë dhe atë Kushtetuese, me gjithë rekomandimet ndërkombëtare, Gjykata Kushtetuese vendosi të ruante të pandryshuar nenin 113 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë që kriminalizon prostitucionin.

Kriminalizimi i punës së seksit, duke u bërë bashkë me pamundësinë e ndryshimit të treguesit të gjinisë, i bën personat transgjinorë veçanërisht të rrezikuar ndaj arrestimeve dhe vuajtjes së dënimeve arbitrare në mjedise me të dënuar të tjerë të të njëjtit seks në shkelje të të drejtave të tyre për dinjitet dhe integritet fizik, duke i ekspozuar ndaj diskriminimit dhe dhunës së sigurt për shkak të identitetit gjinor. Në këtë kontekst përmendim rastin e një anëtareje transgjinore të komunitetit, e cila u mbajt e izoluar për një periudhë 2-vjeçare, që përkon me periudhën e vendosur nga Gjykata si masë për vuajtjen e dënimit. Izolimi 2-vjeçar erdhi si pasojë e mungesës së strukturave të specializuara për trajtimin e rasteve të tilla dhe si rrjedhojë e vakumit ligjor lidhur me njohjen e identitetit gjinor, në shkelje të hapur të nenit 6 dhe nenit 3 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, lidhur me detyrimet positive të shtetit në garantim të të drejtave të çdokujt për proces të rregullt ligjor dhe trajtim dinjitoz.

Në vitin 2013 në një iniciativë të përbashkët mes Këshillit të Europës dhe një grupi ekspertësh shqiptarë u realizua draftimi i një projektligji mbi njohjen e identitetit gjinor, i cili nuk u adoptua asnjëherë nga Parlamenti Shqiptar. Të pyetura në kuadër të këtij raportimi mbi shkaqet e kolapsit të procesit, ekspertet të cilat janë angazhuar me draftimin e ligjit u shprehën, se vlerësonin si shkakun kryesor të mos çuarjes para të procesit, vullnetin e ulët politik.

⁴⁸ Alenaca LGBT (2018) Raporti vjetor mbi situatën e komunitetit LGBTI+ në Shqipëri.

Më tej, ato theksuan nevojën që ndryshime të tilla në legjislacionin shqiptar nevojitet të paraqiten në formën e paketave të integruara ligjore dhe jo në formën e ligjeve individuale. Gjatë procesit të vitit të kaluar të Rishikimit të Përgjithshëm Periodik, Shqipëria u tërhoq nga rregullimi ligjor i çështjes së njohjes së identitetit gjinor për personat transgjinorë, për të paktën 4 vitet e ardhshme, duke ndikuar indirekt edhe në nivelin e implementimit të objektivit 10 të zhvillimit të qëndrueshëm dhe duke lënë mënjanë nga rregulime specifike shumë të nevojshme komunitetin transgjinor.

Ligji për strehimin social⁴⁹ është një nga mjetet juridike më të rëndësishme kombëtare për anëtarët e komunitetit LGBTI+, veçanërisht për personat transgjinorë si target-grupi më i prekur nga problemet e strehimit. Ligji adreson drejtpërdrejtë komunitetin si grup interesi, megjithatë problematikat e ndeshura në realitet nga individët LGBTI+ janë të shumta. Për shkak të dhunës, diskriminimit, stigmës, bulizmit dhe mundësive të kufizuara të punësimit anëtarët e komunitetit e shohin shpesh kryeqytetin si shpëtimin e vetëm drejt të qenit të lirë dhe për të realizuar të drejtën e tyre për një jetesë të pashqetësuar. Sëbashku me shpërnguljen lind edhe nevoja e tyre për akomodim, kryesisht mes marrëdhënieve konaktuale të qerasë.

Aleanca LGBT përpaket t'i asistojë individët në këtë proces, që shpesh i përball me vështirësi të shumta, kosto të papërbalueshme, por edhe me diskriminimin e qiradhënësve për shkak të orientimit të tyre seksual apo identitetit gjinor. Gjatë vitit 2019 janë informuar mbi procedurën dhe plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm 6 persona të komunitetit LGBTI, të cilët pas seancave të këshillimit psiko social shprehën interes të regjistroheshin si banorë të përhershëm në qytetin e Tiranës. Gjatë 2019-ës, 65 persona u informuan mbi programet e strehimit social që aplikon Bashkia Tiranë, përmes seancave informuese individuale dhe në grup, ndërkohë që 35 individë LGBTI+ u asistuan në gjetjen e një shtëpie me qera. Punonjësit e Aleancës LGBT kanë shoqëruar 11 herë personat e interesuar në institucione, me qëllim nxitjen e punonjësve të administratës për t'u dhënë zgjidhje në kohë problematikave të rasteve.

Strehimi dhe problematikat me të për shkak të diskriminimit përbëjnë ende sfidë për anëtarët e komunitetit, ku vetëm gjatë vitit 2019, gjashtë gra transgjinore u nxorrën nga pronarët e shtëpive të tyre për shkak të identitetit gjinor.

Ndër arsyt kryesore të sfidës së strehimit përmendim pamundësinë e përfitimit nga programet sociale të strehimit që ofrojnë Bashkitë për shkak të situatës së tyre sociale të nxitur nga statusi LGBTI+ si edhe ruajtjen e konfidencialitetit në kuadër të sistemit të pikëzimit, ku të dhënat personale dhe statusi LGBTI+ bëhen publike, ndërkohë që individët mund të mos kenë dalë hapur te familjarët dhe rrethi social. Një tjetër problematikë e këtij ligji është edhe fakti i mungesës së disa prej akteve nënligjore në zbatim të tij, të cilat pamundësojnë implementimin korrekt, ku siç theksohet edhe në shkrimin e publikuar nga portavendore.al⁵⁰ shpesh, të gjendur përpara këtij vakumi juridik, për aspekte të ndryshme të përfshira në ligj institucionet përdorin ende referimin te dispozitat e ligjit të vjetër.

⁴⁹UNDP (2017); Të jesh LGBTI në Europën Lindore: Raporti për Shqipërinë.

⁵⁰Ligj Nr. 22/2018 "Për strehimin social".

Një tjetër ligj që paraqet rëndësi të posaçme për individët LGBTI+ në kontekstin kombëtar, është ligji për azilin⁵¹, i cili në përkufizimin që jep për refugjatin sanksionon përkatësinë në një grup të caktuar shoqëror si bazë potenciale për të garantuar status refugjati për personat e persekutuar për shkak të statusit të tyre LGBTI+ në vendet e origjinës. Megjithatë, ligji nuk përmend eksplisht orientimin seksual dhe identitetin gjinor si arsye persekutimi dhe si shkaqe që meritojnë mbrojtje dhe vëmendje të shtuar institucionale. Deri tani, nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e personave LGBTI+ që mund të kenë përdorur me sukses parashikimet aktuale të ligjit, për të përfituar të drejta azili apo mbrojtje të shtuar në shtetin Shqiptar, për shkak të persekutimit të vuajtur në shtetin e origjinës. Ndërkohë, nëse flasim për azilkërkuesit shqiptarë LGBTI+, vihet re një prirje e shtuar e anëtarëve të komunitetit drejt kërimit të azilit në shtete të tjera evropiane për shkak të persekutimit që vuajnë në Shqipëri mbi bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Vetëm gjatë viti 2019, 17 anëtarë të komunitetit LGBTI+ kërkuan azil jashtë Shqipërisë.

Edhe në ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”⁵², ku e vetmja përmendje specifike që bëhet në kuadër të situatës specifike të komunitetit LGBTI+, është ajo e orientimit seksual si bazë për mbrojtjen nga diskriminimi në kuadër të kujdesit shëndetësor, ka probleme të shumta, duke marrë parasysh se nuk përmendet në asnjë rast si bazë për mbrojtje apo kujdes të veçantë identiteti gjinor. Për më tepër, ligji nuk përmend në asnjë moment vijues bazat e orientimit seksual dhe identiteti gjinor, si element që meritojnë përmendje specifike për shkak të situatës së veçantë të fëmijëve LGBTI+, as në kuadër të procedurave të referimit, kur fëmijët nuk janë të regjistruar në zyrat e Gjendjes Civile dhe as në rastet e referimit të çështjeve nga strukturat respektive të mbrojtjes së fëmijëve nga njësitë e qeverisjes vendore. Kjo pamundësi e ligjit aktual për të adresuar situatën e fëmijëve LGBTI+, i vendos ata dhe familjet e tyre në një situatë pasigurie juridike, që meriton ndërmarrjen e hapave të përshtetshme drejt një ligji gjithëpërfshirës dhe të mbështetur efektisht mbi parimet e trajtimit të barabartë.

Gjykojmë me rëndësi të trajtojmë në kuadër të këtij raportimi edhe mosparashikimin nga ana e Kodit të Procedurave Penale të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si arsye të persekutimeve që mund të sjellin mospranimin e kërkesës për ekstradim të personave dhe mosrenditjen e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si shkaqe të diskriminimit që përlligjin moslejimin e ekzekutimit të dënimeve jashtë shtetit. Mungesa e këtyre parashikimeve i vendos individët LGBTI+ para një situatë pasigurie juridike, duke rrezikuar njëherazi mospërmbushjen e detyrimeve pozitive të shtetit Shqiptar në kuadër të angazhimit ndaj Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, por edhe objektivin 10 të zhvillimit të qëndrueshëm, i cili synon legjislacione gjithëpërfshirëse dhe favorizuese për të gjithë anëtarët e shoqërisë, në bazë të trajtimit të tyre të barabartë.

Së fundmi, dëshirojmë të theksojmë në kuadër të këtij objekti situatën e aktivistëve LGBTI+ në Shqipëri, të cilët referohen në raportin e Civil Rights Defenders si kategoria e aktivistëve më të riskuar, sëbashku me aktivistët për të drejtat e viktimave të trafikimit, aktivistëve në krye të lëvizjeve kundër dhunës në familje dhe gazetarëve investigativë⁵³. Sa i përket lirisë së shprehjes së aktivistëve të të drejtave të njeriut, si një nga elementet themelore për arritjen e qëllimeve të aktivizmit që ata kryejnë,

⁵¹<https://portavendore.al/2020/02/18/ligji-i-ri-per-strehimin-bashkia-e-tiranes-sorollat-te-pastrehet-me-ligjin-e-vjeter/>

⁵²Ligj Nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”.

⁵³Ligj Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

siç theksohet edhe në raport, përbën një fushë që vijon të preket dhe limitohet vazhdimisht nga veprimtaria e aktorëve shtetërorë, duke përmendur konkretisht prezantimin e paketës së fundit antishpifje, e cila sanksionon një sërë kufizimesh në lirinë e shprehjes në kuadrin e veprimtarisë së medias online. Aktualisht, nuk ekziston asnjë mjet juridik që i pozicionon aktivistët e të drejtave të njeriut si një kategori, që për shkak të riskut që ndërmmer drejt arritjes së synimeve për barazi dhe drejtësi sociale, meriton vëmendjen e shtuar të autoriteteve shtetërore, në një mjedis ku mentaliteti ua vështirëson tejmas punën dhe shpesh i riskon, duke e bërë pozitën e tyre tejet të pasigurt. Në kuadër të realizimit të Objektivit 10 të Zhvillimit të Qëndrueshëm, vlerësojmë si mjaft të rëndësishme marrjen e masave të përshpejtuara drejt një mbrojtjeje të përforcuar të aktivistëve të të drejtave të njeriut, mes sigurimit të hetimeve efektive në rastet e incidenteve ndaj tyre nga trupa të pavarura dhe të paanshme, që punojnë me transparencë në mbështetje të rolit të paçmueshëm të shoqërisë civile në proceset transformuese shoqërore, të cilat vijnë në të njëjtën linjë me angazhimin e shtetit shqiptar në Agjendën 2030.



**LEAVE NO ONE
BEHIND**

VI. REKOMANDIME

1. Adoptimi i legjislacionit për njohjen e identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit, brenda vitit 2030, në bashkëpunim të ngushtë me organizatat e shoqërisë civile dhe përfshirjen e tyre efektive në kuadër të procedurave të konsultimit publik.
2. Hartimi i strategjive dhe protokolleve të fokusuara te kirurgjitë jokonsensuale dhe të panevojshme që performohen mbi fëmijët interseks dhe të aksesit institucional i personave transgjinorë në kurat hormonale dhe në operacionet e ndërrimit të seksit.
3. Përditësimi dhe plotësimi i kuadrit ligjor ekzistues lidhur me procedurat e riprodhimit të asistuar mjekësor në favor të strukturave publike, duke mundësuar aksesin e shërbimit me kosto të përballueshme nga të gjithë.
4. Përditësimi i ligjit “Për parandalimin e HIV/AIDS-it”, duke përfshirë shërbimet e profilaksisë para ekspozimit, profilaksisë pas ekspozimit në nivel kombëtar dhe aksesin efektiv në ndihmën shoqërore për personat me HIV/AIDS, duke respektuar parashikimet e konfidencialitetit të të dhënave personale sensitive dhe duke lehtësuar procedurat burokratike gjatë procesit.
5. Forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe raportimit të Planit të ardhshëm të Veprimit mbi personat LGBTI+, në funksion të llogaridhënies dhe transparencës së institucioneve publike përballë komunitetit LGBTI+.
6. Adoptimi i legjislacionit që mundëson garantimin e të drejtës së çifteve të të njëjtit seks për martesë apo bashkëjetesë të njohur ligjërisht, brenda vitit 2030.
7. Draftimi dhe adoptimi i protokolleve specifike nga strukturat shtetërore lidhur me rritjen e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve në raport me çështjet LGBTI+, duke përfshirë punonjësit e rendit, stafin akademik, stafin mjekësor, punonjësit e administratës shtetërore në nivel vendor dhe lokal si edhe psikologët dhe punonjësit social.
8. Përditësimi i kurrikulave të edukimit me informacion të saktë dhe të paanshëm lidhur me perspektivën sociale, juridike dhe atë shëndetësore mbi çështjet LGBTI+, duke përfshirë informacion mbi shëndetin seksual dhe riprodhues, që targeton drejtpërdrejtë individët LGBTI+.
9. Përditësimi dhe përafrimi i legjislacionit kombëtar mbi të drejtat e fëmijëve, të drejtën për azil si edhe parashikimet e Kodit të Procedurave Penale lidhur me përfshirjen e klauzolave të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, si baza për mbrojtje të shtuar ndaj subjekteve me status LGBTI+.
10. Draftimi dhe adoptimi i një ligji individual mbi nxitjen e gjuhës diskriminuese dhe gjuhës së urrejtjes, duke evokuar bazat e orientimit seksual dhe identitetit gjinor si shkaqe që legjitimojnë mbrojtjen e specializuar të viktimave të këtyre krimeve.
11. Rritja e kapaciteteve të punonjësve të rendit lidhur me raportimin dhe trajtimin e rasteve të nxitjes së urrejtjes dhe gjuhën diskriminuese të përdorur ndaj komunitetit LGBTI+.
12. Forcimi i bazës juridike lidhur me krimet kibernetike, si nënkategori e krimeve të urrejtjes dhe forcimi i kapaciteteve organike brenda institucioneve të rendit, lidhur me raportimin dhe ndjekjen e vazhdueshme të rasteve.

LISTA E REFERENCAVE

- 1 Civil Rights Defenders (2019) *Human Rights Defenders in the Western Balkans*
- 2 Commission Staff Working Document (2019) *Albania 2019 Report*, Accompanying the document Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic, and Social Committee, and the Committee of the Regions
- 3 Commissioner for Human Rights- *Discrimination on grounds of sexual orientation and gender identity in Europe- 2nd edition: section 5.2*
- 4 Council of Europe (2014) *Co-operation Document Albania 2012-2014*
- 5 European Commission against Racism , and Intolerance, reports on Albania available at: <https://www.coe.int/en/web/european-commission-against-racism-, and-intolerance/albania>
- 6 <https://isna.org/faq/conditions/cah/>
- 7 <https://portavendore.al/2020/02/18/ligji-i-ri-per-strehimin-bashkia-e-tiranes-sorollat-te-pastrehet-me-ligjin-e-vjeter/>
- 8 https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectID=09000016805cf40a
- 9 <https://www.crca.al/sq/news/shqiperi-mbi-100-gra-dhe-vajza-te-vrara-ne-18-vjet>
- 10 <https://www.lgbti-era.org/news/shocking-, and-unacceptable-2020-albania-fails-its-hiv-aids-fight>
- 11 <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23092&LangID=E>
- 12 <https://www.ohchr.org/EN/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=23092&LangID=E>, Pgph. 3.<https://www.reporter.al/femijet-interseks-ne-shqiperi-perballen-me-nderhyrje-kirurgjikale-te-panevojshme/>
- 13 <https://www.reporter.al/femijet-interseks-ne-shqiperi-perballen-me-nderhyrje-kirurgjikale-te-panevojshme> /<https://www.unfe.org/wp-content/uploads/2017/05/UNFE-Intersex.pdf>
- 14 <https://www.unfe.org/wp-content/uploads/2017/05/UNFE-Intersex.pdf> ILGA Europe (2016) *Enlargement Review: Albania 2016*
- 15 ILGA Europe (2016) *Enlargement Review: Albania 2016*
- 16 ILGA Europe (2018) *Report on Albania*
- 17 ILGA Europe (2020) *Report on Albania*
- 18 ILGA Europe, *Rainbow map and index 2020*, available at: <https://www.ilga-europe.org/rainboweurope/2020>
- 19 International Labour Standards Department (2019) *Information paper on protection against sexual orientation, gender identity and expression, and sexual characteristics (SOGIESC) discrimination*
- 20 Ligj Nr. 10107/2009 "Mbi kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë"

- 21 Ligj Nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi"
- 22 Ligj Nr. 121/2014 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë"
- 23 Ligj Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"
- 24 Ligj Nr. 22/2018 "Për strehimin social"
- 25 Ligj Nr. 8876/2002 "Për shëndetin riprodhues"
- 26 Ligj Nr. 9952/2014 "Për parandalimin dhe kontrollin e HIV/AIDS"
- 27 LGBT Alliance (2018) Annual Report on the situation of the LGBTI+ Community in Albania
- 28 MSWY, Document of NAP 2016-2020
- 29 NDI (2015) Public Opinion Poll on LGBTI issues
- 30 Program available at: <https://www.un.org.al/sites/default/files/POC2021EnSig.pdf>
- 31 Statement Delivered on Behalf of LGBTI UN Core Group by H.E. Mrs. Egriselda Aracely González López, Ambassador Permanent Representative of El Salvador to the United Nations; 18 October 2019; New York.
- 32 The Danish Institute- COWI-; Study on Homophobia, Transphobia and Discrimination on Grounds of Sexual Orientation and Gender Identity-Legal Report: Albania by Independent researcher K. Loloçi
- 33 The Plan available at: <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>
- 34 The Strategy available at: <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/278-strategjia-kombetare-per-zhvillim-dhe-integrim>
- 35 UNDP (2017) Being LGBTI in Eastern Europe: Albania Country Report

© Aleanca kundër diskriminimit LGBT

www.aleancalgbt.org

